



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

## **R R E G U L L O R E**

**Nr. 7 Datë 23. 12. 2008**

**PER**  
**DHËNIEN E LICENCËS**  
**“PËR STACIONET RADIO TË ANIJES”**

*Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.522, Datë 23.12.2008*  
*Ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2256, Datë 23.01.2013*

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i rregullores është që nëpërmjet rregullave të përcaktuara në këtë rregullore të sigurohet ofrimi i shërbimit të stacioneve radio të anijës mbi bazën e një licence të harmonizuar me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të rekomanduara nga ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve) dhe Konventa SOLAS ( Safety of Life at Sea).

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i rregullores është publikimi i kriterëve dhe procedurës që zbaton Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për dhënien e licencës “Mbi ofrimin e shërbimit të Stacioneve Radio të anijeve” dhe përcaktimi i kërkesave teknike për caktimin e shenjës së thirrjes dhe kodit MMSI.

## **Neni 3**

### **Baza ligjore**

1. AKEP, nxjerr këtë rregullore në mbështetje të gërmës p) dhe t) të nenit 8 dhe pikës 6 të nenit 64 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**) i ndryshuar, si dhe Strategjinë “Për shërbimin e Radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 05.06.2003 (**VKM Nr. 370**).
2. Dispozitat e karakterit teknik të rregullores bazohen ligjin nr. 9918, VKM Nr. 370, Rekomandimet e ITU dhe Konventën SOLAS për këtë qëllim.
3. Dispozitat proceduriale dhe administrative bazohen në frymën dhe përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9918 i ndryshuar.

## **Neni 4**

### **Detyrimi për licencë**

1. Mjetet e lundrimit, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të instaluar në bord pajisje radiokomunikimi duhet të pajisen me licencë për përdorimin e stacionit radio të anijes.
2. Gjithë mjetet lundruese me kategoritë e përcaktuara sipas Konventës SOLAS, janë të detyruara të pajisen me sistemin global të fatkeqësisë dhe sigurisë në det, GMDSS.
3. Subjekt i Konventës SOLAS janë të gjitha anijet e mallrave me peshë mbi 300 ton, klasa të ndryshme të anijeve të pasagjerëve dhe të anijeve të peshkimit

## **Neni 5**

### **Formulari i aplikimit**

1. Subjekti që kërkon të pajiset me licencë për përdorimin e stacioneve radio të anijes duhet të aplikojë online sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj

- rregulloreje, i cili shoqërohet me tabelën mbi të dhënat teknike dhe deklaratën e pronarit/personit të autorizuar.
2. Formulari i aplikimit online plotësohet tek Moduli i Aplikimit Online për licencë “Për stacionet radio të anijes” në faqen web të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al)

### **Neni 6 Dhënia e Licencës**

1. Licenca i jepet të interesuarit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data që ka dërguar online në AKEP Formularin e aplikimit të plotësuar në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe pasi të ketë kryer të gjitha pagesat përkatëse për marrjen e licencës.
2. Kur AKEP konstaton parregullsi në plotësimin e Formularit të aplikimit të depozituar, i kërkon subjektit rregullimin e tyre brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh pas marrjes së njoftimit online, për parregullsitë e konstatuara.
3. Trajtimi i kërkesës online bëhet nga Drejtoria përkatëse në AKEP dhe Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryetari.
4. Format i licencës sipas Aneksit 2 të kësaj rregulloreje, është në përputhje me Rekomandimin 7 të Radio-Rregullores së ITU.
5. Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes së Licencës dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP.

### **Neni 7 Shenja e thirrjes**

1. Mjeteve të lundrimit që janë të pajisura me pajisje radio i caktohet shenja e thirrjes në përputhje me rregulloret ndërkombëtare të ITU-së.
2. Shenja e thirrjes përcaktohet për mjetet e lundrimit që licensohen për herë të parë nga AKEP dhe është unike për çdo anije.
3. Shenja e thirrjes i mbetet anijes për aq kohë sa nuk ndryshohet pronari apo emri i anijes.
4. Shenja e thirrjes dorëzohet në AKEP kur anija bëhet e papërdorëshme ose nuk zhvillon aktivitet të licensuar, për një periudhe 2 ose më shumë vjet.
5. Shenja e thirrjes nuk transferohet midis anijeve.

### **Neni 8 Formimi i shenjës së thirrjes**

1. Sipas përcaktimit të seksionit III, të nenit 19, të Radio-Rregullores së ITU shenjat e thirrjes të stacionit të anijes formohen si vijon:
  - (a) Dy karaktere dhe dy shkronja, ose
  - (b) Dy karaktere, dy shkronja dhe një shifër ( e ndryshme nga 0 ose 1 ).
2. Stacionet e anijeve që përdorin vetëm radiotelefoni mund të përdorin gjithashtu shenjë thirrje që përbëhet nga:
  - (a) Dy karaktere (me kusht që e dyta të jetë shkronjë) të vijuar nga 4 shifra (të ndryshme nga shifrat 0 ose 1 në rastet kur vijojnë menjëhere mbas një shkronje), ose,
  - (b) Dy karaktere dhe një shkronjë vijuar nga 4 shifra (të ndryshme nga shifrat 0 ose 1 në rastet kur vijojnë menjëhere mbas një shkronje).

3. Sipas APPENDIX 42 (ËRC-2000) të Radio-Rregullores të ITU seritë e shenjës të thirrjes ndërkombëtare për anijet shqiptare është “ZAA - ZAZ”.
4. Formati i shenjës së thirrjes për stacionet radio te anijeve shqiptare, për rastin e përcaktuar në pikën 1 do të jetë:

Z	A	A - Z	A - Z
---	---	-------	-------

Ose:

Z	A	A - Z	A - Z	2 - 9
---	---	-------	-------	-------

### **Neni 9** **Identifikimi i shërbimeve të lëvizshme detare (MMSI)**

1. Kodi i identifikimit të shërbimeve të lëvizshme detare (MMSI- Maritime Mobile Service Identity), përcakton në mënyre unike një anije dhe nevojitet për të operuar me pajisjet DSC (Digital Selective Calling) dhe pajisjet satelitore.
2. Ky kod identifikimi, sipas nenit 19.100 të Radio-Rregullores të ITU, formohet nga një seri 9 shifrash të cilat transmetohen në komunikimet radio në mënyrë që të identifikojë stacionet e anijeve.

### **Neni 10** **Formimi i MMSI**

1. Kodi me 9 shifra që identifikon stacionin e anijës formohet si vijon:

$M_1 I_2 D_3 X_4 X_5 X_6 X_7 X_8 X_9$ ,

ku  $M_1 I_2 D_3$  (Maritime Identification Digits) përfaqëson shifrat e identifikimit detar dhe  $X_4 - X_9$  janë shifra nga 0 – 9.

2. Sipas APPENIX 43 të Radio-Rregullores të ITU, “M I D” për Shqipërinë është “201”.
3. Rekomandohet që:
  - (a) Shifrat  $X_4 X_5 X_6$  do të kenë përkatësisht vlerat 1, 0, 0.
  - (b) Shifrat  $X_7 X_8 X_9$  në rastin e përgjithshëm do të jenë kombinime të shifrave nga 0 deri në 9.
  - (c) Shifrat nga 0 deri në 9, të fillojë dhe të vazhdojë në formatin 001, 002, 003 ...099, 101, 102, 103 ...etj.

### **Neni 11** **Regjistrimi**

AKEP, regjistron të licensuarit në një regjistër i cili publikohet në faqen e internetit dhe

përmban këto të dhëna:

- a) të dhënat mbi licencën (nr., data, vlefshmëria etj);
- b) pronarin e anijes (sh.p.k/sh.a/person fizik);
- c) emrin e anijes;
- d) shenjën e thirrjes;
- e) kodin MMSI;
- f) të dhënat për personin e kontaktit;
- g) pagesat e kryera.

## **Neni 12 Çregjistrimi**

1. Çregjistrimi bëhet nëpërmjet njoftimit online për rastet kur:
  - (a) anija shitet në një shtet tjetër,
  - (b) anija mbytet,
  - (c) anija bëhet e papërdorshme,
  - (ç) anija është jashtë shërbimit, për një kohë 2 ose më shumë vjet.
2. Mbjatësi i Licenses ka detyrim të njoftojë online AKEP-in për rastet e mësipërme.

## **Neni 13 Informimi në ITU**

AKEP, bazuar në Dispozitën 20.16 të Radio-Rregullores informon ITU mbi subjektet e regjistruara (licensuara) apo çregjistruara.

## **Neni 14 Kërkesat teknike**

1. Pajisjet e stacionit radio të anijes duhet të jenë në përputhje me standartet dhe rekomandimet përkatëse të institucioneve ndërkombëtare të njohura e pranuar nga AKEP dhe të zbatueshme në Shqipëri.
2. Frekuencat dhe kanalet e punës që do të përdoren nga stacionet radio të anijes do të jenë ato të përcaktuara nga ITU.
3. Stacionet radio të anijes duhet të përmbushin normat teknike dhe të mos u krijojnë interferenca rrjeteve të tjera.

## **Neni 15 Përdorimi i shërbimeve të stacionit radio-bregdetar**

1. Përdorimi i shërbimeve të stacionit radio-bregdetar nga i licensuari, kryhet në bazë të marrëveshjeve midis tij dhe Autoritetit të Llogarive Detare.
2. Rregullat e komunikimit janë të përcaktuara në Radio-Rregulloren përkatëse të ITU.

## **Neni 16 Bashkëpunimi me Autoritetin e Llogarive Detare.**

1. Marrëdhëniet financiare midis mjeteve lundruese, të cilëve u ofrohet shërbim radiotelekomunikacioni nga stacioni radio-bregdetar me subjektet që ofrojnë shërbimin e komunikimit elektronik (sipërmarrësit), rregullohen nëpërmjet akteve juridike (kontratave) me Autoritetin e Llogarive Detare.
2. Autoriteti i Llogarive Detare është subjekt i autorizuar për këtë lloj aktiviteti dhe vepron si ndërmjetës midis pronarëve të anijes dhe sipërmarrësve, për shlyerjen e detyrimeve financiare të shërbimit të komunikimeve elektronike që u është ofruar.

### **Neni 17**

#### **Mbi përdorimin e stacionit radio në anije**

1. Shërbim i stacionit radio të anijes vendoset nën autoritetin e pronarit ose kapitenit të anijes.
2. Në rastin e përdorimit të frekuencave ndërkombëtare, personi përgjegjës për stacionet radio të anijes, duhet të jetë i pajisur ose të vëzhgohet nga dikush që është i pajisur me Çertifikaten e Operatorit Radio Detar.
3. Pronari ose kapiteni i anijes duhet të sigurojë sekretin e informacioneve të marra gjatë shërbimit të radiokomunikacionit.

### **Neni 18**

#### **Modifikimi i licencës**

1. Modifikimi i licencës bëhet me kërkesën online të subjektit, në rastet kur:
  - (a) ndryshon emri i anijes,
  - (b) kërkohet të ndryshohen ose shtohen pajisjet radio,
  - (c) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e licencës.
2. I licensuari është i detyruar të njoftojë online në AKEP për të gjitha ndryshimet në të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit.

### **Neni 19**

#### **Detyrimet Financiare**

1. Subjekti, me marrjen e njoftimit online nga AKEP për miratimin e licencës së kërkuar, është i detyruar që të paguajë detyrimet financiare të parashikuara për licencën në përputhje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe rregullave të përcaktuara nga AKEP.
2. Mënyra, niveli dhe afati i pagesave në referencë me pikën 1 të këtij neni, publikohen nga AKEP dhe i bashkëngjiten kësaj rregulloreje në formë aneksi.

### **Neni 20**

#### **Vlefshmëria e licensës dhe rinovimi**

1. Licenca e lëshuar sipas kësaj rregulloreje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj.
2. Për rinovimin e licencës, subjekti i drejtohet AKEP-it duke dërguar online kërkesën 1 (një) muaj para përfundimit të vlefshmërisë së saj, duke paraqitur dhe ndryshimet, nëse ka të tilla.

## **Neni 21**

### **Sanksionet**

1. Është i ndaluar përdorimi i stacioneve radio të anijes pa qenë i pajisur nga AKEP me licencë sipas kësaj rregulloreje.
2. Për shkelje të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, kushteve të licencës dhe kërkesave të rregullores, nëse nuk përbëjnë veprë penale AKEP zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 134, 135 dhe 137 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar.

## **Neni 22**

### **Dispozita të tjera**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga KD i AKEP.
2. Çdo ndryshim i mundshëm i Rregullores do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe vendimet dhe rekomandimet e ITU të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

**Miratuar me Vendim Nr. 522, datë 23.12.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP,**  
ndryshuar me Vendim Nr. 2256, datë 23.01.2013, të Këshillit Drejtues të AKEP.

**FORMULAR APLIKIMI ONLINE  
PËR  
PAJISJEN ME LICENCË  
PËR STACIONET RADIO TË ANIJES**

<input type="checkbox"/>	Aplikim për licencë
<input type="checkbox"/>	Rinovimi i licencës egzistuese

<input type="checkbox"/>	Ndryshimi i të dhënave
<input type="checkbox"/>	Ndërprerje aktiviteti/veprimatit (Çregjistrim)

**1. Të dhënat e subjektit:**

1.1	Emri i Personit (juridik/fizik) (Pronari i Anijes)			
1.2	Adresa Postare			
1.3	Telefon/Faks			
1.4	E-mail			
1.5	Data e Regjistrimit në QKR			
1.6	NIPT-i			
1.7	Emri i përfaqësuesit ligjor			
1.8	Numri personal sipas dokumentit të identifikimit - ID			
1.9	Dëshmia e Pronësisë, lëshuar nga Kapiteneria e Portit	Numri	Data	
1.10	Dëshmia e Flamurit, lëshuar nga Kapiteneria e Portit.	Numri	Data	
1.11	Çertifikata e sigurisë së radios, lëshuar nga Regjistri Detar Shqiptar (Pajisjet radio të kësaj çertifikate të plotësohen në tabelën 3)	Numri	Data	
1.12	Çertifikata e kontrollit teknik të Stacioneve Radio të Anijes, lëshuar nga subjekti i autorizuar për këtë lloj aktiviteti ( <i>jo e detyrueshme</i> )	Numri	Data	
1.13	Çertifikata e Minimumit të Ekuipazhit, lëshuar nga Kapiteneria e Përgjithshme	Numri	Data	
1.14	Çertifikata e Operatorit Radiodetar, të paktën për 1 (nje) person, pjestar i ekuipazhit të anijes	Numri	Data	
1.15	Kontratën të lidhur me Autoritetin e Llogarive Detare (nëse ka)	Numri	Data	Emri i Autoritetit:

**2. Të dhëna mbi anijen:**

2.1	Emri i Anijes	
2.2	Shenja e Thirrjes (nëse është caktuar më parë)	
2.3	MMSI (nëse është caktuar më parë)	
2.4	AAIC	
2.5	Porti i Regjistrimit	



### 3. Të dhëna mbi pajisjet radio të anijes:

Nr.	Item / Përshkrimi	Të Instaluar (po ose jo)	Sasia (cope)	Marka	Tipi	Frekuencat
<b>1</b>	<b>Primary systems / Sistemet primare</b>					
1.1	<b>VHF radio installation / instaluar radio VHF</b>					
1.1.1	DSC encoder / Radio dixhitale dekoduese					
1.1.2	DSC watch receiver / Radio marrëse me kohë të caktuar					
1.1.3	Radiotelephony / Radiotelefonia					
1.2	<b>MF radio installation / radio instaluar me frekuence të moduluar</b>					
1.2.1	DSC encoder Radio dixhitale dekodues					
1.2.2	DSC watch receiver / Radio marrëse me kohë të caktuar					
1.2.3	Radiotelephony / Radiotelefonia					
1.3	<b>MF/HF radio installation / radio instaluar me frekuencë të mesme e të lartë</b>					
1.3.1	DSC encoder / Radio dixhitale dekoduese					
1.3.2	DSC watch receiver / Radio marrëse me kohë të caktuar					
1.3.3	Radiotelephony / Radiotelefonia					
1.3.4	Direct-printing-telegrafy / Telegrafi me printim direkt					
<b>1.4</b>	<b>INMARSAT ship earth station / Sacion INMARSAT anije-tokë</b>					
<b>2</b>	<b>Secondary means of alerting / stacioni sekondar i gadishmërisë</b>					
<b>3</b>	<b>Facilities for reception of maritime safety information / Fasilitetet për marrjen e informacionit datar të sigurisë</b>					
3.1	NAVTEX receiver / Marrës NAVTEX					
3.2	EGC receiver / Marrësi EGC					
3.3	HF direct printing / radiotelegraph receiver / Marrësi radiotelegrafik me frekuencë të lartë dhe me printim direkt					
<b>4</b>	<b>Satellite EPIRB / EPIRB satelitor</b>					
4.1	COSPAS-SARSAT / COSPAS-SARSAT					
4.2	INMARSAT / INMARSAT					
<b>5</b>	<b>VHF EPIRB / EPIRB VHF</b>					
<b>6</b>	<b>Ships radar transponder / Radari transponder i anijes</b>					
<b>7</b>	<b>Portable two-way transceivers / radi portative</b>					
8	<b>UAIS</b>					
9	<b>SSAS</b>					
10	<b>LRIT</b>					
11	<b>Radar</b>					
12	<b>Pajisje të tjera</b>					

**Informacion shtesë:**

## **DEKLARATË E PRONARIT/PERSONIT TË AUTORIZUAR**

Nën përgjegjësi të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat, dëshmitë dhe informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit online dhe çdo lidhje të tij janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me çdo kërkesë të parashikuara ligjërisht mbi përgjegjësinë e vetëdeklarimit.

Me marrjen e licencës deklaroj se do të zbatoj :

1. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe aktet nën ligjore të fushës;
2. Kushtet e Licencës;
3. Kërkesat e rregullores për dhënien e licencës “Mbi ofrimin e shërbimit të stacioneve radio të anijes”

\_\_\_\_\_  
(firma, vula)

\_\_\_\_\_  
(emri, mbiemri)

\_\_\_\_\_  
(pozicioni)

Shënim: Në rast se formulari i aplikimit paraqitet i plotësuar nga një person i autorizuar, autorizimi për këtë person duhet të shoqërojë formularin e aplikimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**LICENCË PËRDORIMI E STACIONIT TË ANIJES**  
**SHIP STATION LICENSE**  
**LICENSE DE STATION DE NAVIRE**  
**LICENCIA DE ESTATIO DE BARCO**

Nr. \_\_\_/\_\_\_ Dt. \_\_.\_\_.\_\_\_\_\_

Vlefshmëria e licencës deri \_\_.\_\_.\_\_\_\_\_

Kjo Licencë lëshohet në përputhje me “Rregullore për dhënien e Licencës për Stacion Radio të Anijes” të miratuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Republikës së Shqipërisë dhe Radio-Rregulloren që shoqëron Kushtetutën dhe Konventën e ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve), për instalimin dhe përdorimin e pajisjeve radio të përshkruara më poshtë:

1	2	3	4
<b>Emri i Anijes</b>	<b>Idendifikimi i Stacionit të Anijes</b>		<b>Mbajtësi i licencës</b>
	Shënja e thirrjes	MMSI	

	<b>Aparatura</b>	<b>Tipi ose përshkrimi i aparaturave</b>	<b>Frekuencat</b>
<b>5</b>	<b>Dhënës</b>		
<b>6</b>	<b>Aparatura të tjera (opsionale)</b>		

**KRYETARI**

\_\_\_\_\_  
(Emri, mbiemri, firma vula)

Tirane, Shqipëri.

Datë --.---.-----.